

Përkthim nga gjuha suedeze

faqe 1

Qendra e shëndetësisë në Värmland
Qendra Habilituese për fëmijë dhe të rinjë

data
18- 09- 2013

emërtimi ynë
VËRTETIM

[shën. i përk.] Kjo faq është epajisur me një vulë që ka këtë përbajtje: Drejtoria e Policisë Rajonale
në Värmland, 25- 09- 2013"

Për
Drejtorinë e Policë në Värmland
Sekzioni i Policisë Kufitare
Att: Bengt Andersson
Box 157
651 05 KARLSTAD

DEKLARATË MJEKËSORE
2001- 07- 09 – SF3A, Nes Beqiri
Allegatan 8 B, Igh 8, 682 31 Filipstad

Nesi është një djalë i moshës 12 vjeçare i lindur pas 43 javësh shtatëzani. Gjatë lindjes së tij u bënë disa komplikime që çuan që ai të pësojë mungesë të madhe të oksigenit. Pra Nesi vuan nga ai lloj problemesh që priten pas një dëmtimi të shkaktuar nga mungesa e oksigenit. Ai nuk ka ndonjë pikë tjetër ku shfaqen deformime të ndonjë lloji tjetër. Dëmtimi i trurit tek ai ka shkaktuar tetrapagji. Dëmti i i tij CP është i llojit dyston. Nesi nuk posedon aftësi të zhvendoset vet nga vendi në vend dhe ka aftësi shumë të kufizuar që vetë të vëjë në lëvizje motorikën e vet. Ai ka nevojë për ndihmë për gjithçka. Ai ushqehet përmes një pulle gastrostomie në stomak. Përmes kësaj pulle ai ushqehet më afersisht 1000 ml Nutrisone për çdo ditë. Ai përvëç kësaj mund të haj pak ushqim dhe të pijë përmes gojës por në sasi shumë të vogëla sepse ai ka vështërsi të mëdha për të përbirë ushqimin. Pasi që ai ka filluar me gastrostominë pesha e tij është zhvilluar dukshëm në drejtим pozitiv. Nesi nuk mund gtë shkoj në wc vet. Ai urinon në pelenë. Jashtqitja e tij mbahet e butë me purgativ në formë të Movicol –it.

Nesi ka probleme të shumta me komunikimin. Ai duket se e kupton gjuhën shqipe dhe suedeze. Por ai nuk fol aspak dhe ai mund të kuptohet kryesisht përmes nënës së tij e cila i kupton ato që i thotë ai përmes kontaktit me sy.

Motorika: Problemi i madh i Nesit janë vështëritë e tij të mëdha motorike. Ai e ka një spasticitet të rëndë dhe përpiqet të mbajë lëvizshmërinë e duarve dhe të këmbëve aq sa është e mundur. Ai ka kontraktura (shtangime) të lakueshme në ije (kërdhokulla) dhe përkufizime në anime jashtë të ijeve. Ai ka shtangime të forta në të dy nyjet e gjunjëve, afërisht arrin deri në 100 shkallë në gjurin e djathë dhe 90 shkallë në gjurin e majtë. Përvëç kësaj ka shtërngime në pulpa të këmbës dhe ka kallëp të shputave të këmbës. Ai ka marrë injeksion disa herë me Botox, herën e fundit ishte më 02 korrik 2013. Ai morri ra Botox si në ekstremitetet e larta ashtu edhe të poshtme. I është dhënë pronator teres, pronator quadratus, flexor carpi ulnaris, flexor pollicis brevis bilateral si dhe në ekstremitetet e poshtme mediale hamstrings dhe abductorerna bilateral. Nesi ka nevojë të bartet për ta zhvendosur nga vendi në vend dhe nuk mund t'i ngarkojë fare shputat e këmbëve. Ai nuk ka pasur më herët ndonjë skoliozë të theksuar por tani është vërejtur se kurrizi ka filluar t'i shtrembohet.

Nesi ka probleme me krijimin e këlbazës në rrugët respiratore. Ai trajtohet rregullisht me inhalim të tretsirës së sodium kloridit fiziologjik përmes një aparati (Ailos). Ma rastin e ftofjeve apo ndonjë keqësimi tjetër i jepet edhe inhalim kortizoni (Pulmicort) deh Ventoline poashtu përmes këtij aparati.

Për spasticitetin që ka ai përdorë rregullisht tabletat Baklofen 10 mg, 1 në mëngjes dhe 1 në mbrëmje.

Me sa dihet Nesi nuk vuan nga epilepsia. Ekzaminimi me EEG është bërë në muajin nëntor 2012 për arsyet të sulmeve të panjohura gjatë natës. EEG –ja nuk ka treguar ndonjë formë epilepsie.

Ekzaminimi i trurit me MRT është bërë në muajin maj 2010. Aty tregohet një model karakteristik dhe i rëndë i Hypoxi / totale asfyxi në periudhën e paralindjes tek fëmijët në shtatzëni të plotë. Janë vërejtur ndryshime simetrike të sinjalave si në thalmi ashtu edhe në nuclei lentiformis dhe në pjesën e prapme në dy anët të capsula interna. Ndryshime vazhdojnë sipër në corona radiata dhe më tutje në në substancën e hirtë periorbitike. Është vërejtur se në lartësi me lëndimin corpus callosum është më i hollë.

Radiografia e kurrit e bërë në tetor 2011 ka treguar një skolizë të lehtë konvekse e majtë. Këndi Cobb – 7 shkallë. Skoliozë e lehtë në gjoksë, konvekse e djathtë, këndi i Cobb – afërisht 6 shkallë.

Vërtetohet në detyrë nga

Leif Fleron
Kryemjek
[shën. i përk.] nënshkrim